

URDHËR
Nr.478, datë 27.6.2011

**PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË VENDIMEVE TË KËSHILLAVE
TEKNIKË TË INSTITUCIONEVE TË SHGJSH-SË DHE AKBN-SË PËR APLIKIMET E LEJEVE
MINERARE, PËR SHTYRJEN E AFATIT TË LEJEVE MINERARE DHE PËR SHNDËRRIMIN
E LEJEVE MINERARE TË KËRKIM-ZBULIMIT NË LEJE MINERARE SHFRYTËZIMI**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 43, pika 2, germa “e” të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, dhe pikave 4 dhe 10, germa “A2” dhe “B2” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”,

URDHËROJ:

1. Forma dhe përmbajtja e vendimit të Këshillit Teknik të institucionit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), për çdo aplikim të ri për leje minerare të kërkim-zbulimit përshkruhen në aneksin 1 të këtij urdhri.

2. Forma dhe përmbajtja e vendimit të Këshillit Teknik të institucionit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), për kërkesat për shtyrje të afatit të një lejeve minerare të kërkim-zbulimit përshkruhen në aneksin 2 të këtij urdhri.

3. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, jo më vonë se 45 (dyzetepesë) ditë kalendarike pas datës së aplikimit në QKL për çdo aplikim të ri për një leje minerare kërkim-zbulimi, vlerëson kushtet e lejimit dhe dokumentet vërtetuese për aplikimin, realizon oponencën teknike, shqyrton në Këshillin Teknik projektin e zhvillimit të aktiviteteve minerare të kërkim-zbulimit, programin minimal të punës për kërkim-zbulimin, projektin e rehabilitimit të zonës minerare dhe përcaktimet për vlerat e garancive financiare për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare dhe dërgon në METE vendimin e miratimit ose mosmiratimit të Këshillit Teknik, i cili firmoset nga Sekretari i Këshillit Teknik dhe titullari i institucionit, si dhe ka vulën e institucionit të SHGJSH-së.

4. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike pas, datës së aplikimit në QKL për çdo aplikim për shtyrje afati të një lejeve minerare kërkim-zbulimi, vlerëson kushtet e lejimit dhe dokumentet vërtetuese për aplikimin, realizon vlerësimin në mënyrë dokumentare dhe në terren për realizimin e detyrimeve nga zotëruesit e lejeve minerare të kërkim-zbulimit, arsyet e shtyrjes së afatit, shqyrton në Këshillin Teknik këtë vlerësim dhe dërgon në METE vendimin e Këshillit Teknik të miratimit ose mosmiratimit për shtyrje në afat të lejes dhe të miratimit ose mosmiratimit të projektit të zhvillimit të aktiviteteve minerare të kërkim-zbulimit për periudhën e shtyrjes së afatit, i cili firmoset nga Sekretari i Këshillit Teknik dhe titullari i institucionit dhe ka vulën e institucionit të SHGJSH-së.

5. Forma dhe përmbajtja e vendimit të Këshillit Teknik të institucionit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) për çdo aplikim të ri për leje minerare të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit përshkruhen në aneksin 3 të këtij urdhri.

6. Forma dhe përmbajtja e vendimit të Këshillit Teknik të institucionit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) për kërkesat për shtyrje të afatit të një lejeve minerare të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit përshkruhen në aneksin 4 të këtij urdhri.

7. Forma dhe përmbajtja e vendimit të Këshillit Teknik të institucionit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) për kërkesat për shndërrimin e një lejeve minerare të kërkim-zbulimit në një leje minerare shfrytëzimi, është e njëjtë në formë dhe përmbajtje me vendimin e Këshillit Teknik të këtij institucioni, sipas aneksit 3 të këtij urdhri, pasi ky shndërrim trajtohet si aplikim i ri. Zotëruesi i lejes së kërkim-zbulimit zotëron të drejtën e përparësisë që brenda periudhës kohore të përcaktuar në pikat 2 dhe 3, të nenit 12, të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të realizojë aplikimin për realizimin e këtij shndërrimi.

8. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike pas datës së aplikimit në QKL për çdo aplikim të ri për një leje minerare shfrytëzimi ose kërkim-zbulim-shfrytëzimi, vlerëson kushtet e lejimit dhe dokumentet vërtetuese për aplikimin, realizon oponencën teknike, shqyrton në Këshillin Teknik projektin e zhvillimit të aktiviteteve minerare të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit, programin e investimit për shfrytëzimin ose kërkim-zbulim-shfrytëzimin, projektin e rehabilitimit të zonës minerare dhe përcaktimet për vlerat e garancive financiare për realizimin e programit të investimit dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare, dhe dërgon në METE

vendimin e miratimit ose jomiratimit të Këshillit Teknik, i cili firmoset nga Sekretari i Këshillit Teknik dhe titullari i institucionit dhe ka vulën e institucionit të AKBN-së.

9. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike pas datës së aplikimit në QKL për çdo aplikim për shtyrje afati të një lejeje minerare shfrytëzimi ose kërkim-zbulim-shfrytëzimi, vlerëson kushtet e lejimit dhe dokumentet vërtetuese për aplikimin, realizon vlerësimin në mënyrë dokumentare dhe në terren, për realizimin e detyrimeve nga zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit, arsyet e shtyrjes së afatit, shqyrton në Këshillin Teknik këtë vlerësim dhe dërgon në METE vendimin e Këshillit Teknik të miratimit ose jomiratimit për shtyrje në afat të lejes dhe të miratimit ose jomiratimit të projektit të zhvillimit të aktiviteteve minerare të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit për periudhën e shtyrjes së afatit, i cili firmoset nga Sekretari i Këshillit Teknik dhe titullari i institucionit dhe ka vulën e institucionit të AKBN-së.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço